



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË

**AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË
DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

VITI 2024

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti vjetor paraqet punën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) gjatë vitit 2024, në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin e punës të institucionit dhe në kontekstin e situatës aktuale lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Një pjesë thelbësore e aktivitetit të ASHDMF përqendrohet në **monitorimin e punës së strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijës**, konkretisht të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) dhe Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), në lidhje me identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve. Për këtë arsye, në raport pasqyrohen në mënyrë të detajuar të dhëna statistikore të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, përkatësisë etnike, si dhe informacion mbi ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara, tipologjitë e abuzimeve, nivelet e rrezikut dhe problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të rasteve.

Raporti gjithashtu adreson situatën e **kategorive më vulnerabël të fëmijëve në rrezik**, duke përfshirë:

- Fëmijët jashtë sistemit arsimor,
- Fëmijët e huaj dhe shqiptarë të pashoqëruar,
- Fëmijët në konflikt me ligjin,
- Fëmijët pa kujdes prindëror,
- Fëmijët viktime të dhunës, abuzimit apo neglizhencës.

Tabela e mëposhtme përmbledh indikatorët kryesorë dhe të dhënat statistikore më domethënëse të evidentuara në raportin për vitin 2024.

Numri i rasteve të menaxhuara në total nga PMF	2451
Numri i rasteve të reja	1386
<i>Rastet e reja sipas grupmoshës</i>	
<i>0-3 vjeç</i>	134
<i>4-6 vjeç</i>	131
<i>7-9 vjeç</i>	170
<i>10-12 vjeç</i>	233
<i>13-15 vjeç</i>	328

<i>16-18 vjeç</i>	390
<i>Rastet e reja sipas gjinisë</i>	
<i>Femra</i>	599
<i>Meshkuj</i>	787
<i>Rastet e reja sipas etnisë</i>	
<i>Rom</i>	175
<i>Egjiptian</i>	80
<i>Popullsi maxhoritare (Shqiptare)</i>	1060
<i>Fëmijë me shtetësi të huaj</i>	71
Numri i rasteve të reja të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve	
<i>NJMF</i>	126
<i>Policia</i>	376
<i>OJF</i>	78
<i>Prindi</i>	108
<i>Fëmija</i>	4
<i>Institucione arsimore</i>	225
<i>Institucione shëndetësore</i>	32
<i>Administratori i NE</i>	19
<i>Gjykata</i>	86
<i>Prokuroria</i>	11
<i>Shërbimi i Provës</i>	178
<i>Media</i>	7
<i>Skudrat e terrenit</i>	88
<i>Të tjerë</i>	48
Numri rasteve të mbyllura	741

<i>Rastet e mbyllyra sipas arsyes</i>	
<i>fëmija është mbi 18 vjeç</i>	109
<i>fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera</i>	414
<i>fëmija vdes</i>	0
<i>fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqendrim dhe dosja e tij është transferuar</i>	218
Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut	2451
<i>i ulët</i>	1293
<i>i mesëm</i>	844
<i>i lartë</i>	197
<i>emergjent</i>	117
Numri i vizitave të kryera në familje	3254
Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave	2451
<i>dhunë fizike</i>	159
<i>dhunë seksuale</i>	59
<i>dhunë psikologjike</i>	376
<i>trafikim</i>	47
<i>fëmijë në situatë rruge</i>	227
<i>neglizhim</i>	282
<i>probleme social-ekonomike</i>	733
<i>aftësi e kufizuar</i>	43
<i>mosregjistrim në gjendjen civile</i>	26
<i>fëmijë në konflikt me ligjin</i>	291
<i>dhunë në mjedisin digjital</i>	24
<i>fëmijë pa kujdes prindëror</i>	57

<i>Tjetër</i>	127
Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje sipas llojit të masës	
<i>Masa emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative (total)</i>	91
• Miratuar nga drejtori i shërbimeve shoqërore në bashki	91
• Konfirmuar nga gjykata	63
<i>Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative (total)</i>	32
• Miratuar nga drejtori drejtori shërbimeve shoqërore në bashki	32
• Konfirmuar nga gjykata	29
<i>Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar</i> (Kjo masë miratohet vetëm nga drejtori shërbimeve shoqërore në bashki, nuk ka nevojë për konfirmim nga gjykata)	94
Numri i fëmijëve që janë identifikuar për tu regjistruar në shkollë	202
fëmijë për regjistrim në klasë të parë	21
fëmijë në situatë rruge	17
fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;	2
fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;	5
fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën	144
fëmijë që kanë braktisur shkollën	9
Fëmijët e pashoqëruar	
Numri i kërkesave të shqyrtuara nga ASHDMF për riatdhesim të fëmijëve shqiptarë nga vendet e BE	48
Numri i fëmijëve të riatdhesuar	7
Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar	79
Raste të referuara nga ASHDMF	

Raste të referuara dhe asistence teknike nga ASHDMF për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	94
Ankesa zyrtare tek AMA	8
Raportime për faqe me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme	62

1. Monitorimi i punës së strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka një detyrim të qartë ligjor për të kontrolluar cilësinë e punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor. Ky detyrim buron nga neni 41, pika 3, gërma “ç” i Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, që i njej ASHDMF-së përgjegjësinë për garantimin e ngritjes dhe funksionimit efektiv të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës.

Në funksion të këtij detyrimi, dhe në përmbushje të **masës II.2.1 të Objektivit Strategjik II të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026**, e cila parashikon “*hartimin dhe miratimin me akt normativ të udhëzimit metodologjik për kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, grupeve teknike ndërsektoriale dhe metodologjisë për kontrollin e tyre*”,

ASHDMF, me mbështetjen e UNICEF, ka hartuar dokumentin: “*Metodologjia e kontrollit të cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.*”

Ky dokument shërben si udhëzues praktik dhe teknik, i cili:

- Standardizon dhe unifikon procedurat në përputhje me kërkesat ligjore për referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve;
- Rregullon mënyrën e ushtrimit të kontrollit të cilësisë mbi punën e strukturave përgjegjëse në nivel vendor;
- Drejton sjelljen profesionale të punonjësve të ASHDMF gjatë kryerjes së vlerësimeve të cilësisë.

Procesi i monitorimit përfshin **një kontroll të plotë të tre niveleve kyçe të sistemit vendor të mbrojtjes së fëmijës**:

1. Drejtorinë e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
2. Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) pranë bashkisë;
3. Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) pranë njësive administrative.

ASHDMF, para aplikimit të metodologjisë në shkallë vendi, ka hartuar fillimisht një grup kriteresh cilësore për matjen e performancës dhe funksionimit të strukturave, të cilat janë pjesë integrale e dokumentit metodologjik. Më pas është zhvilluar metodologjia e kontrollit, e cila përshkruan në mënyrë të detajuar hapat e procesit të monitorimit.

Me Udhëzimin nr. 767, datë 28.12.2023, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është miratuar zyrtarisht “Metodologjia e kontrollit të cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”, duke vendosur një standard të ri kombëtar për monitorimin, transparencën dhe llogaridhënien e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri.

ASHDMF ka filluar tashmë zbatimin e kësaj metodologjie, duke nisur procesin e kontrollit të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Tiranë. Ky është një hap konkret për vendosjen në praktikë të zbatueshmërisë së udhëzimit të miratuar.

2. Zbatimi i të drejtave të fëmijëve në vend. Monitorimi i treguesve për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar

2.1 Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHDMF) është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

ASHDMF mbledh të dhëna në nivel kombëtar lidhur me rastet e menaxhuara dhe punën e realizuar nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Bazuar në legjislacion, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) janë struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimit të rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Sipas ligjit Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës (PMF) pranë bashkisë ka detyrën funksionale të menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi që nga momenti i identifikimit apo referimit deri në mbyllje të rastit.


Bazuar në VKM Nr. **636, datë 26.10.2018** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHDMF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” (e ndryshuar me VKM Nr. 471, datë. 06.07.2022), NJMF-të raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin

e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi. Këto të dhëna përfshijnë fëmijët në territorin e bashkisë dhe njësive administrative në juridiksionin e saj.

Për vitin 2024 kanë raportuar 61 NJMF, të cilat ushtrojnë funksionin në të gjitha bashkitë në vend.

Nga raportimet rezulton se 53 NJMF kanë menaxhuar të paktën një rast dhe 8 NJMF nuk kanë menaxhuar asnjë rast gjatë vitit 2024, si Bashkia Skrapar, Bashkia Poliçan, Bashkia Libohovë, Bashkia Tepelenë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Dropull, Bashkia Pustec, Bashkia Konispol.

Për vitin 2024 shifrat tregojnë për një total prej **2451 fëmijë të trajtuar** nga NJMF në nivel kombëtar. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktima të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit etj. Nga këto, janë identifikuar **1386 raste të reja**, pjesa tjetër janë raste të mbartura, të cilat vazhdojnë të jenë në menaxhim nga NJMF. Gjatë 2024 janë **mbyllur 741 raste**.



Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raportojnë NJMF e bashkisë Tiranë me **538** raste, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësive administrative, si dhe NJMF-të e bashkive Shkodër me **192** raste, Durrës **145** raste, Elbasan **108** raste, Krujë **102** raste.

Ndërkohë numrin më të vogël të rasteve të menaxhuara e raportojnë NJMF e bashkive Përmet dhe Selenicë me **1** rast, bashkitë Peqin, Memaliaj dhe Finiq me **2** raste.

Rastet e Reja

Për vitin 2024, në 1386 raste të reja të identifikuar nga NJMF, vihet re një numër më i madh i fëmijëve të grupmoshës 16-18 vjeç, me **390** raste të reja, ndërsa grupmosha 4-6 vjeç ka pasur numrin më të vogël të rasteve, me **131** raste. Gjithashtu, NJMF kanë trajtuar **134** raste të

grupmoshës 0-3 vjeç, **170** raste të grupmoshës 7-9 vjeç, **233** raste të grupmoshës 10-12 vjeç si dhe **328** raste të grupmoshës 13-15 vjeç.



Për vitin 2024 numrin më të lartë të rasteve të reja të trajtuara nga NJMF e zenë meshkujt me **787** raste, ndërkohë femrat janë në shifrën e **599** rasteve.

Nga 1386 raste të reja të identifikuar këtë vit, **1060** raste kanë qenë fëmijë nga popullsia mazhoritare, **175** raste janë fëmijë nga etnia rome dhe **80** raste janë fëmijë nga etnia egjiptiane. Gjatë 2024, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë marrë në mbrojtje **71** raste të fëmijëve me shtetësi të huaj.

Identifikimi/Referimi i Rasteve

Detyrimi për raportim i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë ata në rrezik, parashikohet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punonjësit të cilët punojnë me fëmijët në nenin 67 të ligjit 18/2017 “Detyrimi për raportim”, ku çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

NJMF raportojnë pranë Agjencisë rastet e identifikuar/referuara të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ndaj fëmijëve qoftë nga vetë ata si punonjës të NJMF si persona përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe nga aktorë publikë dhe jo publikë apo dhe struktura të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me NJMF. Gjithashu, çdo qytetar, familjar apo pjestar i komunitetit mund të raportojë rastet e dhunës ndaj fëmijëve pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve që kanë në territor.

Për vitin 2024 vihet re që numri më i madh i rasteve të reja është identifikuar dhe referuar tek PMF nga policia, **376** raste, por edhe vetë institucionet arsimore kanë identifikuar **225** raste. NJMF nisur edhe nga puna që bëjnë në terren, nëpërmjet identifikimit proaktiv, kanë identifikuar **126** raste.

Institucionet shëndetësore kanë kontribuar në identifikimin dhe referimin e rasteve, përkatësisht **32** raste të referuara nga institucionet arsimore, një shifër e ulët edhe pse një numër më i madh rastesh abuzimi apo dhune paraqitet pranë institucioneve shëndetësore.

Është rritur ndërgjegjësimi për raportim edhe nga anëtarët e familjes. Vetë fëmijët kanë raportuar rastet e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit pranë strukturave përgjegjëse me **4** raste dhe prindërit kanë raportuar **108** raste.

Përsa i përket institucioneve të drejtësisë ka pasur një ndërgjegjësim lidhur me referimin e rasteve pranë strukturave të NJMF, e cila konsiston në bashkëpunimin dhe koordinimin e këtyre strukturave me njëra tjetrën. Shërbimi i Provës ka numrin më të lartë të rasteve me **178** raste, ndërkohë gjykatat kanë referuar **86** raste dhe Prokuroria **11** raste.

Administratorët e ndihmës ekonomike në bashki dhe aktorët e shoqërisë civile ofrojnë shërbime pranë komuniteteve në nevojë dhe kanë mundësi të mira për identifikimin e rasteve në territor. OJF kanë referuar pranë NJMF **78** raste dhe administratorët e ndihmës ekonomike **19** raste në nevojë për mbrojtje.

Mediat dhe skuadrat e terrenit kanë qënë bashkëpunëtorë në referimin e rastit duke shënuar **88** raste skuadrat e terrenit dhe **7** raste mediat.

Një kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve kanë dhënë, ASHDMF, qytetarët, shërbimet sociale rajonale, Avokati i Popullit, zyrat e përmbarimit etj. Këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë” në grafikun më poshtë (**48** raste).



Rastet e Mbyllura

Gjatë vitit 2024, janë mbyllur **741** raste. Numri më të madh i rasteve, rreth **414** raste janë mbyllur për arsye se fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera. Kjo është një e dhënë pozitive, pasi tregon se PMF dhe të gjithë strukturat në nivel vendor kanë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhej fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut.

Ndërkohë **218** raste janë mbyllur për arsyen se fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqendrim dhe dosja e tij është transferuar dhe **109** raste janë mbyllur për arsye të arritjes së moshës madhore të fëmijëve.



Niveli i Rrezikut

Vlerësimi i nivelit të rrezikut është një hap i rëndësishëm gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Sipas nivelit të rrezikut në të cilin ndodhet fëmija, vendosen masat e mbrojtjes të përshtatshme për fëmijën ose përcaktohen veprimet që duhet të ndërmerren nga aktorët vendorë të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijës. Vlerësimi dhe përcaktimi i nivelit të rrezikut për fëmijën kryhen njëkohësisht me ofrimin e ndihmës fillestare të nevojshme për fëmijën.

Nga të dhënat për vitin 2024 rezulton se në përgjithësi NJMF trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme, përkatësisht **1293** raste me nivel të ulët dhe **844** raste me nivel të mesëm.

Gjithashtu, PMF kanë menaxhuar **197** raste me rrezikshmëri të lartë dhe **117** raste në nivel të menjëhershëm rreziku.



Gjatë këtij viti NJMF-të në gjithë vendin kanë realizuar **3254 vizita në familje**. Vizita kanë si qëllim kryesor identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Përmes tyre bëhet edhe vlerësimi i situatës social ekonomike të familjeve, njohja me rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët, komunikimi dhe ndërveprimin ndërmjet anëtarëve të familjes me fëmijët. Gjithashtu përmes vizitave bëhet rivlerësimi i rasteve të cilat janë në proces menaxhimi. Nga raportimet rezulton se NJMF-të kanë realizuar vizita në familje, në mënyrë periodike dhe sipas nevojës së rastit. Në rastet kur strukturat për mbrojtjen e fëmijës kanë vendosur “Masa mbrojtëse” për fëmijën, vizitat në familje kanë qënë më të shpeshta dhe të qëllimshme për ndjekjen e situatës.

Analiza e Problematikave të Rasteve të Menaxhuara

Rastet e fëmijëve të menaxhuara nga NJMF-të gjatë vitit 2024 përfshijnë një game të gjerë problematikash, të cilat pasqyrojnë kompleksitetin dhe ndërthurjen e faktorëve që çenojnë mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve. PMF-të, në bashkëpunim me strukturat e tjera publike dhe jo publike, kanë ndërmarrë masa dhe ndërhyrje të ndryshme për të siguruar mbrojtjen, asistencën dhe rehabilitimin e fëmijëve në nevojë.

Një pjesë e konsiderueshme e rasteve të menaxhuara përfshijnë fëmijë që vijnë nga **familje me probleme të theksuara social-ekonomike**, ku mungesa e të ardhurave financiare shoqërohet me përjashtim social, pamundësi për akses në shërbime bazë dhe cenim të të drejtave të fëmijës.

Në këtë kontekst, koncepti i varfërisë trajtohet në kuptimin e saj të gjerë, që përfshin jo vetëm mungesën e të ardhurave, por edhe:

- Mungesën e aksesit në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës;
- Vonesa apo mungesë në marrjen e shërbimeve shëndetësore bazë;

- Mohimin e të drejtave të fëmijës për mbrojtje, pjesëmarrje dhe zhvillim të plotë;
- Izolimin social, mungesën e strehimit të sigurt apo kushteve të përshtatshme jetese.

Për vitin **2024**, NJMF-të kanë menaxhuar **733 raste** të fëmijëve që vijnë nga këto kushte. Në këto raste, fëmijët janë marrë në mbrojtje përmes ndërhyrjeve të ndryshme, duke përfshirë:

- Mbështetje me ndihma ekonomike ose ushqimore;
- Akses në arsim dhe pajisje mësimore;
- Kujdes mjekësor dhe ndjekje psiko-sociale;
- Bashkëpunim me shërbimet vendore për strehim dhe mbështetje familjare.



Gjatë vitit 2024, NJMF-të kanë identifikuar dhe menaxhuar raste të abuzimeve të natyrave të ndryshme. Abuzimi ndaj fëmijëve shfaqet në forma të ndryshme: fizik, emocional, seksual, ekonomik apo përmes neglizhimit. Kjo lë pasojë të thella në shëndetin mendor dhe fizik të fëmijëve, procesin e tyre arsimor, duke shkaktuar largim nga shkolla ose ulje të përfshirjes dhe rezultateve, vetëvlerësimin dhe zhvillimin e shëndetshëm psiko-social.

Në të gjitha rastet e evidentuara, PMF ka ndërhyrë për të siguruar mbrojtje të menjëhershme, përmes referimit në struktura të tjera, hartimit të planit individual të mbrojtjes dhe ndjekjes së rregullt të rastit, duke përfshirë policinë, sistemin shëndetësor, drejtësinë dhe institucionet arsimore, sipas rastit.

Gjatë vitit 2024, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve kanë trajtuar **376 raste të dhunës psikologjike** ndaj fëmijëve, duke e renditur këtë problematikë si të dytën më të shpeshtë në punën e tyre. Kjo tendencë në rritje reflekton jo vetëm përmasat e fenomenit, por edhe sfidat e vazhdueshme që përballen strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në adresimin e dhunës emocionale brenda familjes.

Dhuna në familje prek të gjithë anëtarët, por fëmijët janë ndër më të ndjeshmit ndaj pasojave të saj. Ata jo vetëm që mund të jenë viktime direkte të lëndimeve fizike apo kërcënimeve, por shpeshherë përjetojnë trauma të thella emocionale edhe kur janë vetëm dëshmitarë të konflikteve të dhunshme mes prindërve apo të rriturve të tjerë në familje. Këto përjetime ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin emocional, social dhe psikologjik të fëmijës, me pasoja që mund të shtrihen përtej fëmijërisë.

Një tjetër faktor shqetësues që ka ndikuar negativisht në mirëqenien e fëmijëve është rritja e numrit të divorceve dhe zvarritja e proceseve gjyqësore për zgjidhjen e tyre. Konflikti i zgjatur mes prindërve shpeshherë shoqërohet me përfshirjen e fëmijëve në dinamikën e konfliktit, ku ata përdoren si mjet presioni apo hakmarrjeje. Kjo sjell pasoja të rënda emocionale dhe psikologjike për fëmijët, të cilët gjenden të përfshirë në tensione të vazhdueshme, shpesh të pambrojtur nga mbështetja emocionale e duhur. Mosrespektimi nga ana e prindërve i vendimeve gjyqësore që rregullojnë kujdestarinë, të drejtën e takimit dhe detyrimet për kujdes ndaj fëmijës, ka kërkuar ndërhyrjen e strukturave të përmbartimit gjyqësor dhe të forcave të rendit. Këto ndërhyrje, ndonëse të domosdoshme, shpesh përjetojnë nga fëmijët si përvoja stresuese, duke shtuar më tej ngarkesën e tyre psikologjike.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të tyre themelore dhe një cenim të thellë të integritetit fizik, emocional dhe psikologjik. Ajo është manifestuar në forma të ndryshme, përfshirë abuzimin seksual, ngacmimin seksual, përdhunimin, shfrytëzimin seksual me qëllime përfitimi ekonomik, si dhe ekspozimin e fëmijëve ndaj përmbajtjeve apo sjelljeve të papërshtatshme. Gjatë vitit 2024, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve kanë trajtuar gjithsej **59 raste të dhunës seksuale**, një numër që ndonëse nuk përfaqëson shkallën reale të problemit – për shkak të natyrës së ndjeshme dhe të fshehur të këtyre rasteve – mbetet shqetësues.

Statistikat dhe përvoja në terren tregojnë se në shumicën e rasteve, abuzimi seksual ndodh brenda rrethit të ngushtë të besimit të fëmijës, nga persona të afërt, të njohur dhe shpesh me autoritet moral apo emocional në jetën e fëmijës. Këtu përfshihen anëtarë të familjes, të afërm, komshinj, shoqëria. Kjo situatë e bën edhe më të vështirë zbulimin dhe raportimin e rasteve, pasi fëmija mund të ndihet i frikësuar, i turpëruar apo i përfshirë në ndjenjën e fajit.

Gjithashtu, është vënë re një formë tjetër abuzimi ndaj vajzave adoleshente, të cilat mashtrohen apo manipulohen nga individë më të rritur, shpesh përmes lidhjeve të rreme emocionale, premtimeve të dashurisë apo përfitimeve materiale. Këto vajza shndërrohen në viktime të abuzimeve seksuale sistematike dhe, në raste të caktuara, përfundojnë në rrjete trafikimi dhe shfrytëzimi për prostitucion. Rekrutimi i tyre shpesh ndodh përmes rrjeteve sociale ose kontakteve të drejtpërdrejta në komunitete të cënueshme, ku mungojnë mbikëqyrja prindërore. Vajzat nga familje me probleme sociale, ekonomike, ose me mungesë të strukturës mbështetëse janë më të ekspozuara ndaj këtij rreziku. Fenomene të tilla janë veçanërisht shqetësuese pasi përfshijnë

aspekte të krimit të organizuar, manipulimit psikologjik dhe dhunës sistematike, që lënë pasojë të rënda dhe të zgjatura në jetën e viktimave.

Fëmijët dhe adoleshentët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, që vijnë nga familje me prindër me sëmundje të shëndetit mendor apo që vuajnë nga varësia ndaj substancave, janë më të rrezikuar për të rënë pre e formave të ndryshme të shfrytëzimit seksual. Mungesa e mbështetjes sociale, izolimi dhe mungesa e aksesit në arsim dhe shërbime shëndetësore janë faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cenueshmërisë së tyre.

Gjatë vitit 2024, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve kanë trajtuar **159 raste të dhunës fizike** ndaj fëmijëve, duke e renditur këtë formë dhune ndër shqetësimet më të shpeshta në punën e përditshme të strukturave mbrojtëse. Dhuna fizike ndodh kryesisht brenda familjes dhe është e lidhur me konflikte të natyrave të ndryshme mes anëtarëve të saj, përfshirë marrëdhëniet prind-fëmijë apo ndërveprime me të afërm të tjerë. Përjetimi i dhunës fizike nga fëmijët sjell pasojë të rënda në zhvillimin e tyre psikologjik, social dhe emocional, duke ndikuar negativisht në ndjenjën e sigurisë, vetëvlerësimin dhe sjelljen e tyre në shkollë apo në komunitet.

Nga rastet e raportuara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), vihet re se dhuna fizike ndaj fëmijëve është një problem që ndërvepron me faktorë të shumtë si: varfëria, problemet bashkëshortore të prindërve, divorci, mungesa e mbështetjes sociale dhe kulturore, si dhe stresi kronik në familje. Në disa raste, ndërhyrja e institucioneve është përqendruar më shumë në aspektin ekonomik të problematikës, si ofrimi i ndihmës materiale ose sistemimi i strehimit, ndërkohë që mungon mbështetja psikologjike e specializuar për fëmijën, e domosdoshme për të adresuar pasojat që dhuna lë në mirëqenien e tij.

Një tjetër fenomen shqetësues është përhapja e dhunës fizike ndërmjet adoleshentëve, kryesisht në ambiente shkollore apo jashtë tyre. Konfliktet midis bashkëmoshatarëve, që shpesh nisin nga ngacmime, përjashtim social, xhelozia apo ndikimi i rrjeteve sociale, eskalojnë në përplasje fizike. Në shumë raste, kjo dhunë nuk perceptohet si e tillë nga vetë të rinjtë për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit apo normalizimit të sjelljeve agresive si pjesë e rritjes. Dhuna ndërmjet adoleshentëve jo vetëm që prek drejtpërdrejt viktimat, por krijon edhe një mjedis të pasigurt dhe frikësues për të gjithë nxënësit, duke ndikuar negativisht në përfshirjen në procesin arsimor dhe mirëqenien psikologjike.

Përsëritja e rasteve të dhunës dhe mungesa e reagimit të duhur mund ta kthejnë atë në një model të rrezikshëm ndërveprimi. Roli i mësuesve dhe psikologëve shkollore është thelbësor për të identifikuar këto sjellje në kohë, për të ndërmjetësuar konfliktet dhe për të edukuar fëmijët me aftësi sociale dhe emocionale që parandalojnë sjelljet e dhunshme.

Sipas raportimeve për vitin 2024, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve kanë menaxhuar **282 raste neglizhimi**, një ndër format më të zakonshme dhe më pak të dukshme të abuzimit ndaj fëmijëve.

Neglizhimi përkufizohet si mungesa e qëllimshme ose e paqëllimshme e përkujdesjes prindërore për nevojat themelore të fëmijës – përfshirë sigurinë, ushqimin, kujdesin shëndetësor, arsimimin, mbikëqyrjen dhe strehimin. Këto mangësi, të përsëritura ose të rënda, ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, emocional dhe social të fëmijës dhe përbëjnë një shkelje të rëndë të të drejtave të tij.

Shumë nga rastet e identifikuara kanë të bëjnë me mungesën e vëmendjes së prindërve ndaj ndjekjes së rregullt të shkollës nga fëmijët, pamundësinë për të siguruar kujdes shëndetësor në kohë, apo neglizhencën në mbikëqyrjen e tyre në mjedise potencialisht të rrezikshme. Në disa raste ekstreme, janë raportuar situata ku fëmijët janë braktisur plotësisht nga prindërit dhe lënë pa asnjë lloj përkujdesjeje apo mbështetje. Këto situata paraqesin jo vetëm rrezik për jetën dhe shëndetin e fëmijëve, por edhe sfida të mëdha për institucionet që duhet të ndërhyjnë për strehimin dhe mbrojtjen e tyre.

Megjithëse pjesa më e madhe e fëmijëve të neglizhuar vijnë nga familje në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, janë evidentuar edhe raste ku mungesa e përkujdesjes nuk lidhet me varfërinë, por me mungesën e aftësive prindërore, papërgjegjshmëri, mungesë lidhjeje emocionale apo probleme të shëndetit mendor të prindërit. Prindërit me vështirësi të theksuara psikologjike apo që abuzojnë me substanca shpesh janë të paaftë të ofrojnë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për rritjen e fëmijës.

Gjatë vitit 2024, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) kanë trajtuar gjithsej **227 raste të fëmijëve në situatë rruge**, një kategori që mbetet ndër më të ndjeshmet dhe të marginalizuara në shoqëri. Fëmijët në situatë rruge përfshihen në aktivitete si lypja, shitja e sendeve të vogla, mbledhja e mbetjeve të riciklueshme apo angazhime të tjera joformale që i ekspozojnë ata ndaj rreziqeve të shumta. Shumica e këtyre fëmijëve vijnë nga familje me sfida të thella ekonomike dhe sociale, shpesh me akses të kufizuar në shërbimet publike bazë si arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale.

Këta fëmijë janë të ekspozuar ndaj trafikimit, dhunës, abuzimit fizik e seksual, shfrytëzimit ekonomik, përfshirjes në aktivitetin e grupeve kriminale si dhe ndaj kushteve të vështira që dëmtojnë seriozisht shëndetin dhe zhvillimin e tyre psikologjik dhe emocional. Si pasojë, ata nuk e realizojnë të drejtën për një jetë dinjitoze, për arsimim cilësor dhe për një zhvillim të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre. Identifikimi i shumicës së këtyre rasteve është bërë nga skuadrat e punës në terren, të ngritura në bashkitë “Hotspot”, duke treguar rëndësinë e mobilizimit institucional dhe ndërsektorial për adresimin efektiv të fenomenit.

Gjatë vitit 2024, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) kanë trajtuar **291 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin**, duke përfaqësuar një segment të ndjeshëm të popullsisë fëmijë që kërkon ndërhyrje të kujdesshme, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse. Fëmijët në konflikt me ligjin përfshihen në sjellje të ndryshme delikvente si vjedhje, dëmtime të pronës, pjesëmarrje në grupe

kriminale, shpërndarje ose transport të lëndëve narkotike, si dhe në raste më të rralla, edhe në vepra të dhunshme.

Faktorët që ndikojnë në përfshirjen e fëmijëve në veprimtari të paligjshme janë të shumtë dhe shpesh ndërthuren: varfëria ekstreme, mungesa e mbikëqyrjes prindërore, abuzimi në **familje**, braktisja e shkollës, presioni i grupit të bashkëmoshatarëve, mungesa e aktiviteteve zhvilluese, traumat psikologjike, apo ndikimi i mediave dhe teknologjisë. Raste të shumta vijnë nga mjedise ku fëmijët nuk kanë modele pozitive, akses në edukim cilësor apo struktura që promovojnë përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, roli i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve është vendimtar jo vetëm në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve, por veçanërisht në parandalimin e përfshirjes së mëtejshme të fëmijëve në veprimtari kriminale dhe në promovimin e alternativave rehabilituese. Për çdo rast të evidentuar, NJMF ka hartuar një Plan Individual të Mbrojtjes, i cili përfshin një vlerësim të hollësishëm të situatës së fëmijës, mbështetje psikologjike, ndihmë ligjore, ndërmjetësim me familjen, referim në shkollë ose në kurse profesionale, si dhe monitorim të vazhdueshëm nga profesionistët socialë.

Për fëmijët **nën moshën e përgjegjësisë penale**, është garantuar mbështetje përmes një qasjeje të orientuar drejt edukimit, socializimit dhe riintegritimit në komunitet. Për fëmijët **mbi moshën e përgjegjësisë penale**, NJMF-të kanë bashkëpunuar ngushtë me prokuroritë, policinë, gjykatat, institucionet e paraburgimit apo të dënimit penal për të mitur, duke garantuar që e drejta për mbrojtje ligjore, trajtim njerëzor dhe akses në arsim të mos cenohet.

Një shqetësim në rritje përbëjnë rastet kur fëmijët përdoren nga grupe të rritura kriminale si mjet për kryerjen e veprave penale, duke shfrytëzuar statusin e tyre “të mitur” për të shmangur ndëshkimin penal si “të rritur”. Ky fenomen kërkon ndërhyrje të specializuara nga strukturat ligjzbatuese dhe një mekanizëm më të fortë të referimit dhe ndjekjes së rasteve

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar **47 raste të trafikimit të fëmijëve**, një fenomen i rëndë dhe i ndërlikuar që çënon në mënyrë të thellë të drejtat, sigurinë dhe të ardhmen e fëmijëve viktimë. Trafikimi përfshin forma të ndryshme të shfrytëzimit, si shfrytëzimi seksual, puna e detyruar, lypja e organizuar apo detyrimi për kryerjen e veprave penale, ku fëmijët shpesh manipulohen, kërcënohen ose mashtrohen nga individë apo rrjete kriminale.

Një numër i konsiderueshëm vajzash të mitura janë tërhequr nga persona të rritur përmes manipulimit emocional dhe mashtimit nëpërmjet rrjeteve sociale, për t’u shfrytëzuar në trafikim seksual ose prostitucion. Vajzat nga familje të varfra, pa kujdes prindëror apo me prindër që përballen me sëmundje të shëndetit mendor, janë veçanërisht të ekspozuara ndaj këtij rreziku.

Për trajtimin e këtyre rasteve, NJMF-të kanë bashkëpunuar me Autoritetin Përgjegjës pranë MB, qendrat rezidenciale për viktimat e trafikimit, organizatat partnere dhe shërbimet publike, për të ofruar një paketë gjithëpërfshirëse mbështetëse që përfshin shërbime shëndetësore, psikologjike, ligjore, sociale, strehim emergjent, veshmbathje dhe mbështetje për riintegrimin. Njëkohësisht, janë ndërmarrë përpjekje për të punuar edhe me familjet e fëmijëve për të parandaluar rikthimin në rrjetet e trafikimit dhe për të garantuar një mjedis të sigurt për jetën e fëmijës.

Janë trajtuar **43 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuar** gjatë 2024. PMF kanë trajtuar raste kur fëmijët me PAK janë përballur me sfida si: aksesit i pamjaftueshëm në programet e identifikimit dhe ndërhyrjeve të hershme, shërbimet mbështetëse në komunitet, kujdes shëndetësor dhe arsimin e vërtetë gjithëpërfshirës. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet më i vështirë e më kompleks, kur familjet e fëmijëve me PAK bien në varfëri, pasi përballen me kostot e larta që sjell kujdesi. Gjithashtu këto fëmijë përballen me mungesën e mbrojtjes nga rreziku i shtuar për shkak të dhunës dhe abuzimit me të cilin ata mund të përballen.

Gjatë vitit 2024, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) kanë trajtuar **26 raste të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile**. Këto raste paraqesin një problematikë të ndjeshme, pasi mungesa e regjistrimit në regjistrin civil pengon ushtrimin e një sërë të drejtash themelore, siç janë e drejta për identitet, për arsimim, për kujdes shëndetësor dhe për mbrojtje sociale.

Shumica e rasteve të evidentuara kanë të bëjnë me fëmijë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm nga vendet ku kanë lindur, nuk janë regjistruar në regjistrin civil shqiptar. Krahës këtyre, PMF-të kanë ndjekur edhe raste kur familjet, për shkak të kushteve të rënda ekonomike, mungesës së informacionit, nivelit të ulët të arsimimit dhe mungesës së asistencës ligjore, nuk kanë qenë në gjendje të ndjekin apo përmbushin procedurat e regjistrimit të fëmijëve.

Në përgjigje të kësaj situatë, NJMF-të në bashkëpunim me strukturat vendore të administratës civile dhe organizatat e specializuara, kanë ndërmarrë hapa konkretë për sensibilizimin dhe mbështetjen direkte të familjeve, duke u ofruar atyre informacionin e nevojshëm për procedurat, asistencë në përgatitjen e dokumentacionit, si dhe duke i orientuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë zyrave të gjendjes civile për të finalizuar procesin e regjistrimit.

Siguria e fëmijëve në mjedisin online është një çështje në zhvillim në Shqipëri, e cila ka filluar të marrë vëmendje të veçantë vetëm gjatë viteve të fundit, paralelisht me rritjen e përdorimit të internetit dhe pajisjeve digjitale nga fëmijët e moshave të ndryshme. Në kushtet e një aksesimi gjithnjë e më të hershëm dhe më intensiv të teknologjisë, fëmijët përballen me rreziqe të reja që lidhen me dhunën në internet, përfshirë ngacmimin online (cyberbullying), abuzimin seksual digjital, pornografinë e fëmijëve, manipulimin emocional nga të rritur keqdashës (grooming) dhe ekspozimin ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme ose të dëmshme.

Gjatë vitit 2024, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) kanë trajtuar **24 raste të dhunës dhe abuzimit në mjedisin digjital**. Në këto raste, fëmijët janë hasur në situata të rrezikshme që përfshijnë ngacmime të vazhdueshme përmes rrjeteve sociale, presione për dërgimin e fotove intime, shpërndarjen pa leje të materialeve personale, manipulime me qëllim shfrytëzimi seksual, si dhe bullizim online që ka shkaktuar pasoja psikologjike serioze, si ankth, izolim social, ulje të vetëbesimit dhe vështirësi në funksionimin emocional dhe arsimor të fëmijëve.

Përballë këtyre sfidave, ASHDMF dhe PMF kanë punuar ngushtësisht me fëmijët dhe prindërit e tyre për të rritur ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen digjitale, duke ofruar këshillime individuale dhe

familjare, informacione mbi mënyrat e identifikimit të rreziqeve në internet dhe hapat që duhen ndjekur për raportimin dhe mbrojtjen nga dhuna online. Prindërit janë udhëzuar të ushtrojnë mbikëqyrje aktive dhe të kultivojnë besimin dhe komunikimin e hapur me fëmijët, në mënyrë që ata të ndihen të sigurt për të raportuar çdo përvojë shqetësuese në internet.

Një tjetër aspekt thelbësor në këtë drejtim ka qenë bashkëpunimi i PMF-ve me institucionet arsimore, ku janë organizuar takime informuese dhe ndërgjegjësuere në shkolla për sigurinë online, si dhe me institucionet ligjzbatuese dhe organizatat partnere, për të garantuar një reagim të koordinuar dhe mbështetës ndaj çdo rasti të dhunës digjitale ndaj fëmijëve.

Gjatë vitit 2024 janë trajtuar **57 raste të fëmijëve pa kujdes prindëror** nga strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve. Këto raste përfshijnë fëmijë që ndodhen në situata të braktisjes nga të dy prindërit, fëmijë të lindur jashtë martese që nuk janë njohur ligjërisht nga prindërit, si dhe fëmijë të prindërve të divorcuar ku asnjëri prej tyre nuk ushtron përgjegjësi prindërore. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve vijnë nga familje që përballen me vështirësi të mëdha social-ekonomike, mungesë strehimi, probleme me shëndetin mendor, dhunë në familje ose emigrim të paligjshëm të prindërve. Për fat të keq, në disa raste është vënë re një refuzim i qëllimshëm i prindërve për të ushtruar kujdes prindëror, duke e lënë fëmijën në mëshirë të fatit, pa siguri, stabilitet emocional dhe kujdes bazik. Mungesa e dashurisë, e mbështetjes dhe e strukturës familjare ka ndikime të thella dhe afatgjata në zhvillimin emocional, social dhe arsimor të fëmijëve, duke rritur ndjeshmërinë e tyre ndaj abuzimeve, shfrytëzimit dhe sjelljeve devijante.

Në menaxhimin e këtyre rasteve, vendosja e fëmijëve në institucion mbetet gjithmonë opsioni i fundit, vetëm kur të gjitha mundësitë për vendosje pranë të afërmeve biologjikë ose në një familje kujdestare janë shteruar. PMF-të ndërhyjnë për të mbështetur prindërit biologjikë apo kujdestarët ligjorë me aftësim prindëror, këshillim, ndihmë ekonomike dhe monitorim të vazhdueshëm, me synim riintegrimin e fëmijës në një ambient familjar të sigurt dhe mbështetës.

Gjatë vitit 2024, janë raportuar gjithashtu **57 raste të tjera** të cilat nuk përfshihen në kategoritë klasike të indikatorëve të mbrojtjes së fëmijës, por që paraqesin kompleksitet dhe kërkojnë ndërhyrje të specializuara. Këtu përfshihen:

- **Fëmijë të rikthyer nga zonat e luftës (Siri):** të cilët shpesh vijnë të traumatizuar dhe kërkojnë përkujdesje psikologjike dhe mbështetje për reintegrim social dhe arsimor.
- **Fëmijë me probleme të shëndetit mendor,** të cilët përballen me mungesë të aksesit në shërbime të specializuara, mungesë diagnostikimi të hershëm apo trajtimi të vazhdueshëm.
- **Sjellje devijante ose të rrezikshme sociale,** si përdorimi i substancave narkotike, braktisja e shkollës, agresiviteti apo përfshirja në aktivitete kriminale.
- **Riatdhesimi i fëmijëve nga vendet e BE-së ose vendet fqinje,** ku PMF ndjek procedurat për vlerësim, mbrojtje dhe riintegrim në familje ose komunitet.
- **Deinstitucionalizimi,** ku fëmijët e vendosur për një kohë të gjatë në institucione përkujdesjeje kalojnë në përkujdesje familjare ose komunitare.

- **Largimi i fëmijëve nga banesa**, shpesh si pasojë e dhunës, konflikteve familjare ose mungesës së mbështetjes emocionale dhe sociale.

Për të gjitha këto raste, ndërhyrjet e NJMF-ve janë të shumëfishta dhe kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera përgjegjëse si shkollat, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, policinë, institucionet e drejtësisë, QKMF-të dhe organizatat partnere. Synimi është jo vetëm mbrojtja e fëmijës në momentin e krizës, por edhe ofrimi i një perspektive afatgjatë për integrim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Masat e Mbrojtjes

Në ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcaktohen masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurtë për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për vitin 2024 NJMF kanë marrë në **total 217 Masa Mbrojtje**.

Nga raportimet rezulton se nga NJMF janë marrë **91 Masa emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative**. Këto masa sigurojnë largimin e fëmijës nga një situatë rreziku, qoftë nga familja apo prindërit, në mënyrë të menjëhershme.

Gjithashtu janë marrë **32 Masa të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative**. Ndërkohë janë aplikuar **94 Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar**. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj ligjor si strukturë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe garantimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka zhvilluar gjatë vitit 2024 një mekanizëm të strukturuar dhe të përditshëm të monitorimit të mediave të shkruara dhe vizive, përfshirë burimet online dhe rrjetet sociale. Qëllimi i këtij monitorimi është identifikimi në kohë reale i rasteve të mundshme që përfshijnë shkelje të të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë fëmijë të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar ose të ekspozuar ndaj përmbajtjeve që çenojnë mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Përveç monitorimit aktiv të mediave, Agjencia trajton edhe ankesat e referuara nga qytetarët, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat shqyrtohen me prioritet dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”. Në bazë të këtij ligji, ASHDMF ka funksionin të ofrojë mbështetje teknike për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, gjatë procesit të menaxhimit të rasteve, me qëllim garantimin e një ndërhyrjeje të shpejtë, të koordinuar dhe në interesin më të mirë të fëmijës.

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka identifikuar, ndjekur dhe referuar për trajtim në Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) përkatëse **94 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të menjëhershme**. Këto raste përfshijnë fëmijë në situata dhune në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, neglizhimi prindëror.

ASHDMF, përmes mbështetjes teknike të vazhdueshme dhe monitorimit aktiv të NJMF-ve, ka ndihmuar në garantimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes për secilin rast, në përputhje me procedurat standarde dhe me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera përgjegjëse në nivel vendor.

Ky proces ka forcuar më tej rolin e Agjencisë si një hallkë kyçe në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, duke promovuar reagimin institucional të koordinuar dhe rritjen e përgjegjshmërisë për rastet që prekin të drejtat e fëmijëve.

2.2 Monitorimi i realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave statistikore

Bazuar në Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 26.10.2018, i ndryshuar me VKM nr. 471, datë 06.07.2022 “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka përgjegjësi ligjore për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore që lidhen me situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Ky proces realizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore dhe vendore, përfshirë ministritë e linjës, bashkitë dhe Institutin e Statistikave (INSTAT), duke u bazuar në listën e treguesve të përcaktuar në aktin nënligjor përkatës. Të dhënat mbledhen në baza vjetore dhe paraqiten në një format të standardizuar, në njësi matëse si numër dhe përqindje, të ndara sipas grupmoshave, gjinisë, njësive të qarkut dhe në nivel kombëtar.

Treguesit statistikore të mbledhur janë të strukturuar në gjashtë fusha kryesore që përfshijnë:

1. Mbrojtjen sociale,
2. Arsimin dhe zhvillimin e hershëm të fëmijërisë,
3. Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi,
4. Shëndetësinë,
5. Aksesin në drejtësi, dhe
6. Drejtësinë për të miturit.

Për garantimin e transparencës dhe aksesit publik në të dhënat mbi situatën e të drejtave të fëmijëve, ASHDMF ka zhvilluar një **platformë digjitale** të dedikuar për vizualizimin e treguesve

statistikorë: <http://statistikafemijet.gov.al>, e integruar në faqen zyrtare të Agjencisë: <http://femijet.gov.al>.

Platforma ofron pasqyrë vizuale të të dhënave të raportuara nga institucionet në nivel qendror dhe vendor, duke mundësuar shfaqjen grafike të treguesve dhe analizën e trendeve në vite për periudhën 2019–2024. Kjo i mundëson përdoruesve — politikëbërësve, institucioneve, studiuesve, medias dhe publikut të gjerë — të kenë një mjet të besueshëm për monitorimin, vlerësimin dhe krahasimin e zhvillimeve në fushën e të drejtave të fëmijëve në kohë reale.

Për më tepër, kjo platformë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së llogaridhënies institucionale dhe mbështet hartimin e politikave më të informuara, të bazuara në evidencë dhe të orientuara drejt nevojave reale të fëmijëve në vend. Përditësimi dhe përdorimi sistematik i saj përbën një komponent thelbësor të funksionit monitorues të Agjencisë.

3. Mbrojtja e fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar që riatdhesohen nga vendet e BE dhe rajonit si dhe femijet e huaj të pashoqëruar

Sipas dispozitave në VKM Nr. 111 datë 6.3.2019 “*Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimit të fëmijës*”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe të huaja, të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijës.

3.1 Riatdhesimi i fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar

Gjatë vitit 2024, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka vijuar ndjekjen sistematike të procedurave për marrjen në mbrojtje të fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar nga vendet e Bashkimit Europian dhe rajoni. Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë autoritetet përkatëse të vendeve pritëse dhe përfaqësitë diplomatike shqiptare.

ASHDMF ka ofruar asistencë teknike për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) në nivel vendor, të cilët janë aktorët kyç në procesin e vlerësimit të situatës familjare dhe sociale të fëmijëve të kthyer, me qëllim garantimin e mirëqenies së tyre dhe mbrojtjes nga çdo formë rreziku apo rikthimi në kushte që mund të cenojnë zhvillimin dhe sigurinë. Kjo përfshin: vlerësimin e nevojave të fëmijës, gjendjen e kujdestarit ligjor, kushteve të strehimit, aksesit në arsim, shëndetësi dhe mbështetje psikosociale, si dhe hartimin e një plani individual të ndërhyrjes pas kthimit.

Gjatë 2024, janë trajtuar gjithsej **48 kërkesa zyrtare** për vlerësimin e situatës familjare me qëllim riatdhesimin e fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar, të ndodhur në vende të ndryshme të BE-së dhe më gjerë. Kërkesat janë adresuar nga autoritetet kompetente të vendeve pritëse, të cilat kanë kërkuar verifikimin dhe garantimin e kushteve për kthimin në mënyrë të sigurt të fëmijëve.

Nga ana e institucioneve shqiptare përgjegjëse, gjatë vitit 2024 janë **pritur dhe riatdhesuar 7 fëmijë**, për të cilët është garantuar ndjekja institucionale dhe menaxhimi në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës.

Kërkesat për riatdhesim janë adresuar nga një gamë e gjerë shtetesh përfshirë: Gjermaninë, Suedinë, Francën, Italinë, Greqinë, Mbretërinë e Bashkuar, Kosovën, Norvegjinë dhe Islandën. Në çdo rast, ASHDMF ka koordinuar veprimet me institucionet vendore përkatëse, për të siguruar që fëmijët e kthyer të përfshihen në sistemin e mbrojtjes, të monitorohen vazhdimisht dhe të kenë akses në shërbime mbështetëse që ndihmojnë riintegrimin e tyre të suksesshëm në komunitet dhe familje.

Kjo ndërhyrje shënon një komponent të rëndësishëm të mbrojtjes ndërkufitare të fëmijëve dhe të forcimit të përgjigjes institucionale për fëmijët e pashoqëruar dhe në situata vulnerabël, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë në këtë fushë.

3.2 Fëmijët e huaj të pashoqëruar

Gjatë vitit 2024, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka trajtuar **79 raste të reja të fëmijëve të huaj të pashoqëruar**, të cilët janë identifikuar brenda territorit shqiptar në kushte të pasigurta, pa kujdestarë ligjorë dhe pa mbështetje familjare. Këta fëmijë janë konsideruar në situatë rreziku të menjëhershëm dhe janë trajtuar në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Fëmijët e huaj të pashoqëruar identifikohen kryesisht nga strukturat e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Policia e Shtetit, si dhe nga autoritetet përgjegjëse për azilin dhe refugjatët. Pas identifikimit, strukturat policore ndjekin procedurat përkatëse ligjore dhe referojnë rastin menjëherë pranë Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) në territorin ku është konstatuar fëmija. ASHDMF informohet zyrtarisht për çdo rast dhe koordinon veprimet për marrjen në mbrojtje dhe trajtimin e mëtejshëm të fëmijëve.

Të gjithë fëmijët janë vendosur në mbrojtje të menjëhershme dhe janë akomoduar në qendra emergjence, ku u janë ofruar shërbimet bazë dhe mbështetëse të domosdoshme, si: ushqim, veshmbathje, strehim, transport, mbështetje psikologjike, si dhe çdo shërbim tjetër i identifikuar gjatë vlerësimit individual të rastit. Zakonisht, këta fëmijë nuk kanë dokumente identifikimi, por

ndihma dhe mbrojtja ofrohen mbi bazën e vetëdeklarimit të tyre si fëmijë, duke respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe parimin e moskthimit në vendet ku mund të jenë në rrezik.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet akomodimi afatmesëm dhe afatgjatë i fëmijëve të huaj pas përfundimit të periudhës emergjente. Mungesa e strukturave të specializuara për akomodimin e tyre përtej fazës së parë të reagimit ka ndikuar në vështirësinë për të garantuar një zgjidhje të qëndrueshme për rastet që nuk kërkojnë ose nuk marrin rrugën e riatdhesimit të menjëhershëm.

Pjesa dërmuese e këtyre fëmijëve e përdorin Shqipërinë si vend transit, me destinacion final një vend të Bashkimit Evropian. Ata zakonisht shprehin dëshirën për të mos qëndruar në Shqipëri dhe nuk kërkojnë azil, duke preferuar të rikthehen në vendet fqinje (Greqi) ose të vijojnë lëvizjen drejt vendeve të tjera.

Në përputhje me këtë situatë, ASHDMF ka mbështetur procesin e rikthimit vullnetar të fëmijëve në vendet e tyre të origjinës, në bashkëpunim me strukturat e policisë, punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar që procesi të realizohet në mënyrë të sigurt, dinjitoze dhe me respekt të plotë për të drejtat e fëmijës.

ASHDMF vijon të kërkojë përmirësime në sistemin e mbrojtjes për këtë kategori të ndjeshme, përmes hartimit të protokolleve të qarta ndërinstitucionale, ngritjes së strukturave të përkohshme akomoduese, dhe forcimit të kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në menaxhimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

4. Mbrojtja e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, të trafikuar dhe në situatë rruge

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës për Luftën kundër Trafikimit të Personave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoritë Vendore të Policisë, si dhe me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, ka zhvilluar takime të përbashkëta ndërinstitucionale në 11 bashki qendër qarku.

Qëllimi i takimeve ka qenë:

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor;
- Rritja e efikasitetit në identifikimin e hershëm të rasteve të fëmijëve viktime ose viktime të mundshme të trafikimit (VT/VM);
- Mbështetja dhe menaxhimi i rasteve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Këto takime janë zhvilluar në kuadër të zbatimit të **masës së objektivit specifik 2.2 të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025**, që ka në fokus rritjen e profesionalizmit dhe trajnimin ndërdisiplinor të vazhduar të profesionistëve që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë.

Pjesëmarrësit në takime përfshinë përfaqësues nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), specialistë nga Seksionet për Hetimin e Trafikeve, specialistë për trajtimin e dhunës në familje, specialistë të policimit në komunitet, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të përfshira në mbrojtjen e fëmijës.

Gjatë takimeve, u diskutua në mënyrë të detajuar mbi:

- Nxitjen e bashkëpunimit mes PMF-ve dhe strukturave të policisë për trajtimin e rasteve të VT/VMT;
- Zbatimin e mekanizmave të referimit dhe monitorimit;
- Identifikimin e sfidave ekzistuese dhe propozimin e masave për përmirësim të mëtejshëm të reagimit institucional.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë zhvilluar edhe **seanca trajnuese** me fokus praktik, ku u trajtuan çështje si:

- Identifikimi i indikatorëve të hershëm të trafikimit të fëmijëve;
- Procedurat e referimit të rasteve dhe mbrojtjes së viktimave;
- Zbatimi i Protokolleve të Bashkëpunimit Ndërinstitucional;
- Siguria dhe ofrimi i mbështetjes psiko-sociale për fëmijët viktime.

Rezultatet kryesore të arritura:

- Janë zhvilluar takime në 11 bashki qendër qarku;
- Janë përfshirë në trajnime dhe aktivitete të drejtpërdrejta **226 profesionistë**, përfshirë punonjës të policisë dhe Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës;
- Është forcuar bashkëpunimi ndërmjet strukturave të linjës për një reagim më të shpejtë, të koordinuar dhe më efikas në trajtimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve.

Ky angazhim institucional shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një mekanizmi funksional, të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

Fëmijët në situatë rruge përbëjnë një nga kategoritë më të rrezikuara të fëmijëve në lidhje me cënimin e të drejtave të tyre themelore, përfshirë të drejtën për arsim, mbrojtje, kujdes shëndetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm. Gjatë vitit 2024 është intensifikuar puna ndërinstitucionale për mbrojtjen e kësaj kategorie fëmijësh, si në nivelin qendror ashtu edhe vendor, duke u reflektuar në rritjen e numrit të fëmijëve të identifikuar dhe të trajtuar, si dhe në hartimin e planeve të

përbashkëta të ndërhyrjes ndërmjet shërbimeve sociale të bashkive dhe strukturave të Policisë së Shtetit.

ASHDMF, në përmbushje të misionit të saj, ka ndërmarrë një sërë veprimesh koordinuese dhe monitoruese. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, janë dërguar kërkesa zyrtare për informacion dhe raportim mbi masat e ndërmarra për mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge në **20 bashki “Hot Spot”**: Berat, Kuçovë, Dibër, Bulqizë, Durrës, Krujë, Rrogozhinë, Kavajë, Cërrik, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Shkodër, Kamëz, Vlorë, Himarë, Sarandë, Lezhë dhe Tiranë. Qëllimi i kësaj nisme ishte monitorimi i zbatimit të masave nga bashkitë për mbrojtjen efektive të fëmijëve në rrugë.

Në zbatim të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, bashkive u është rikujtuar detyrimi për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik dhe puna e detyruar, përfshirë brenda familjes. U është kërkuar që të hartojnë plane emergjente për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e rasteve, si dhe për të forcuar përgjegjësinë e tyre në zbatimin e politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Skuadrat e terrenit dhe ndërhyrja në zonat problematike

Gjatë periudhës janar–qershor 2024, kanë qenë aktive **49 skuadra terreni** në këto bashki: Tiranë (15), Durrës (10), Krujë (5), Vlorë (5), Korçë (3), Pogradec (3), Himarë (3), Fier (2), Kavajë (2), Berat (4), Sarandë (2), Kamëz (1), Lezhë (1), Cërrik (1), Kuçovë (1), Shkodër (1), Dibër (1).

Këto skuadra janë ngritur pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në bashki dhe përbëhen nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (PMF) dhe Punonjësi social me përvojë, të bashkisë ose nga organizata të shoqërisë civile/qendra ditore.

Skuadrat patrollojnë në hapësira publike të njohura për frekuentim nga fëmijët në rrugë dhe ofrojnë ndihmën e parë, realizojnë vlerësimin e shpejtë të situatës dhe bëjnë referimin e menjëhershëm tek strukturat përkatëse. Në raste me rrezik të lartë, sidomos gjatë ndërhyrjeve në orët e vona, njoftohet Policia e Shtetit për të siguruar mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësve në terren.

Gjatë sezonit veror është vërejtur një rritje e ndjeshme e fëmijëve që lypin apo shesin në rrugë, veçanërisht në qytetet bregdetare dhe ato me fluks turistik. Fëmijët shpeshherë shfrytëzohen nga vetë familjarët apo individë të tjerë, në mënyrë të organizuar. Ndërsa për vite me radhë kjo situatë është lidhur kryesisht me komunitetin rom dhe egjiptian, në vitin 2024 është konstatuar edhe një rritje e përfshirjes së fëmijëve nga komuniteti mazhoritar në këtë fenomen.

Në rastet kur fëmijët janë shfrytëzuar nga prindërit/kujdestarët ligjorë, pavarësisht ndërhyrjes me shërbime mbështetëse, janë përgatitur dosje të dokumentuara dhe janë depozituar pranë strukturave të Policisë dhe Prokurorisë për ndjekje penale.

Nga raportimet e NJMF-ve, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit janë **ndjekur penalisht 23 të rritur për shfrytëzim të fëmijëve**, të ndarë si më poshtë:

- Tiranë: 11 raste
- Durrës: 10 raste
- Shkodër: 2 raste

Në funksion të përmirësimit të reagimit institucional, **12 bashkitë**: Dibër, Berat, Fier, Durrës, Lezhë, Sarandë, Kamëz, Pogradec, Kuçovë, Krujë, Himarë dhe Tiranë kanë **miratuar plane të përbashkëta ndërhyrjeje** ndërmjet policisë dhe shërbimeve sociale, për të rritur efikasitetin në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrugë.

Ne 9 bashki (Dibër, Durrës, Krujë, Kavajë, Pogradec, Shkodër, Kamëz, Lezhë dhe Tiranë) janë krijuar **databaza funksionale për fëmijët në situatë rruge**, të cilat shërbejnë për:

- Identifikimin e rasteve përsëritëse
- Ndjekjen e zonave më problematike
- Verifikimin e lëvizshmërisë së fëmijëve ndër-bashkiake
- Dokumentimin e shërbimeve të ofruara për çdo rast

Bashkitë, përmes PMF-ve dhe aktorëve lokalë, kanë zhvilluar:

- Seanca ndërgjegjësuere për prindërit dhe fëmijët mbi pasojat e punës së detyruar dhe lypjes.
- Sesione informuese në shkolla dhe komunitet për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat e fëmijëve dhe penalitetet për shfrytëzim.
- Kampi veror për fëmijët nga mosha 6–12 vjeç, në disa bashki, me fokus përfshirjen dhe angazhimin social të fëmijëve në situatë rruge.

5. Zbatimi i të drejtës për arsim. Regjistrimet në shkollë të fëmijëve që braktisin shkollën

Si në çdo fillim të vitit të ri shkollor, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka monitoruar realizimin e të drejtës për arsimim të fëmijëve për vitin akademik 2024–2025, me fokus të veçantë tek fëmijët në nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijët në situatë rruge, ata që vijnë nga familje me vështirësi social-ekonomike si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Mbështetur në marrëveshjen trepalëshe të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Ministrisë së Brendshme (MB) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrueshme shkollore”, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) kanë realizuar identifikimin në terren të fëmijëve që duhen regjistruar në shkollë.

Në bashkëpunim me shkollat dhe Zyrat Vendore Arsimore, janë evidentuar gjithsej **202 fëmijë** për t'u regjistruar në shkollë për vitin akademik 2024–2025, të ndarë sipas kategorive si më poshtë:

- 9 fëmijë që kanë braktisur shkollën;
- 144 fëmijë që rrezikojnë ta braktisin shkollën;
- 5 fëmijë mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar kurrë më parë në shkollë;
- 2 fëmijë të paregjistruar në gjendjen civile;
- 17 fëmijë në situatë rruge;
- 21 fëmijë për regjistrim në klasën e parë;
- 4 fëmijë të kthyer nga emigracioni dhe të paregjistruar në gjendjen civile.

Pas përpunimit të listave të fëmijëve, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ndjekjen dhe realizimin e procesit të regjistrimit të fëmijëve në institucionet arsimore përkatëse.

6. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në mjedisin digital

Mbështetur në nenin 27 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) shqyrton çdo raportim që lidhet me faqe apo materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet. Këto raste raportohen pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), i cili merr masat përkatëse për bllokimin e tyre.

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar **62 raportime**, kryesisht nga fëmijë, prindër dhe Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të fëmijëve në rrjetet sociale.

Të gjitha rastet janë përcjellë pranë AKSK-së, që në bashkëpunim me Policinë e Shtetit ka ndërmarrë veprimet përkatëse për identifikimin e viktimave dhe autorëve, si dhe për mbylljen e faqeve apo adresave përkatëse.

Në rastet kur viktimat është identifikuar, ASHDMF ka përcjellë rastin pranë PMF përkatës për menaxhim në terren dhe marrjen në mbrojtje të fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 578, datë 03.10.2018.

Për vitin 2024, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë menaxhuar gjithsej **24 raste të dhunës në mjedisin digital**, të cilat përfshijnë:

- Shantazhim dhe kërcënim;
- Publikime të fotove apo videove me përmbajtje intime e të papërshtatshme;
- Hapje të profileve false në rrjetet sociale;
- Bullizim online dhe ofendime në aplikacionet WhatsApp, TikTok etj.

Rastet janë referuar në polici dhe janë ndjekur nga strukturat për krimet kibernetike. Në bashkëpunim me këto struktura, është mundësuar mbyllja e adresave apo profileve që bullizonin ose shantazhonin fëmijët.

PMF kanë kryer vlerësimet e situatës, kanë mbledhur Grupet Teknike Ndërinstitucionale (GTN) në nivel vendor dhe kanë hartuar **Planet Individuale të Mbrojtjes** për çdo fëmijë. GTN përbëhen nga profesionistë të strukturave vendore të policisë, arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale.

Në bashkëpunim me anëtarët e GTN, PMF kanë përcaktuar masat konkrete për mbrojtjen e fëmijëve dhe kanë ofruar shërbim psikologjik, kryesisht nga psikologët e shkollave, por në raste të veçanta edhe nga profesionistë të licencuar të përzgjedhur nga familjet. Raste të tilla monitorohen në mënyrë periodike nga PMF në bashkëpunim me psikologët e shkollës.

Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe edukative

Në zbatim të **Marrëveshjes së Bashkëpunimit** mes ASHDMF dhe AKSK dhe në përputhje me objektivat e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021–2026) dhe Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (2020–2025), gjatë periudhës shkurt–dhjetor 2024 janë zhvilluar:

- **33 aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese** në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në bashkitë Tiranë, Durrës, Kukës, Gramsh, Cërrik, Lezhë, Kuçovë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Përmet dhe Berat. Në këto aktivitete janë përfshirë **1277 fëmijë** dhe **244 profesionistë**, përfshirë mësues, prindër dhe punonjës psikosocialë.
- **4 workshop-e** të dedikuara për profesionistë dhe prindër në Tiranë, Kukës, Durrës dhe Cërrik. Janë trajnuar gjithsej **200 profesionistë** dhe **43 prindër**.

Pjesëmarrësit janë informuar mbi mënyrat e raportimit të rasteve të bullizmit, ngacmimit dhe shantazhit online, praktikat më të mira për lundrim të sigurt në internet si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin dixhital.

Respektimi i të drejtave të fëmijëve në media

Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik dhe në përçimin e informacionit, por raportimi i papërshtatshëm mund të sjellë pasoja të rënda për fëmijët, sidomos kur cenohen privatësia, dinjiteti apo zhvillimi i tyre emocional dhe psikologjik. Respektimi i të drejtave të fëmijëve gjatë trajtimit mediatic të ngjarjeve që i përfshijnë ata mbetet një sfidë e vazhdueshme në kontekstin mediatic shqiptar.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ushtron monitorim të përditshëm të mediave të shkruara, audiovizive dhe online, me qëllim evidentimin, dokumentimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Ky monitorim përfshin analizën e përmbajtjes së publikimeve për të identifikuar mungesën e etikës profesionale, ekspozimin e

panevojshëm të imazhit të fëmijëve, publikimin e të dhënave të ndjeshme dhe përshkrimet traumatike apo të dhunshme që mund të ndikojnë negativisht tek audienca e mitur.

Gjatë vitit 2024, ASHDMF ka evidentuar gjithsej **11 raste** të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në media. Konkretisht:

- **8 raste** janë referuar pranë **Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)** për mungesë etike në raportimin e rasteve që përfshijnë fëmijë. Si rezultat, AMA ka adresuar shqetësimet përkatëse dhe ka **tërhequr vëmendjen zyrtarisht nëntë televizioneve** që kishin publikuar materiale të papërshtatshme.
- **3 raste të tjera** janë ndjekur nga ASHDMF nëpërmjet mediave sociale dhe portaleve online. Këto janë raportuar kryesisht nga qytetarë që gjatë përdorimit të platformave online kanë vërejtur raste të shpërndarjes së pamjeve, informacionit të ndjeshëm apo përmbajtjes së papërshtatshme për fëmijët.

Në rastet që përfshijnë platformat online, ku aktualisht nuk ekziston një autoritet specifik që merret me mbikëqyrjen dhe ndëshkimin e shkeljeve, ASHDMF ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta përmes komunikimit me administratorët e portaleve, përmes telefonit apo emailit, për t'i informuar mbi cenimin e të drejtave të fëmijëve dhe për të kërkuar heqjen e materialeve përkatëse. Në shumicën e rasteve është arritur fshirja e përmbajtjes së papërshtatshme, megjithatë, procesi ka qenë i vështirë për shkak të:

- mungesës së adresave të sakta të kontaktit të portaleve;
- mungesës së gatishmërisë nga ana e platformave për të bashkëpunuar;
- mungesës së një kuadri ligjor detyrues për mediat online.

ASHDMF thekson se kjo është një ndërhyrje që kërkon kapacitete të shtuara dhe instrumente të mirëpërcaktuara ligjore për të pasur impakt më të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi institucional dhe promovimi i etikës në raportimin mediatik

Për të përmirësuar cilësinë e raportimit mediatik dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ASHDMF ka marrë pjesë aktive në takimet ndërinstitucionale të organizuara për këtë qëllim. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar mënyrat për të avancuar respektimin e standardeve etike dhe është adresuar nevoja për një kod etik më të ashpër dhe më gjithëpërfshirës, veçanërisht në raportimet që përfshijnë fëmijët.

ASHDMF ka dorëzuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive një grup rekomandimesh zyrtare, që përfshijnë:

- Promovimin e historive pozitive dhe edukative që kanë në qendër fëmijët;

- Përdorimin e gjuhës së ndjeshme dhe etike në raportimet që përfshijnë fëmijë në situata të vështira;
- Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere për gazetarët dhe redaksitë mediatike;
- Mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të fëmijëve, sidomos në raste që përfshijnë dhunë, viktimizim apo trauma;
- Përhapjen e informacionit mbi të drejtat e fëmijëve përmes programeve publike dhe edukative në media.

ASHDMF mbetet e angazhuar që të vazhdojë rolin e saj si institucion garantues për respektimin e të drejtave të fëmijëve në çdo fushë të jetës publike, përfshirë sferën mediatike, dhe nxit një qasje më të përgjegjshme, etike dhe bashkëpunuese nga të gjithë aktorët e medias në vend.

7. Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin

Fëmijët janë më të prirur për të hyrë në kontakt me ligjin, sidomos kur jetojnë në kushte të vështira sociale, në një realitet të pasigurt dhe në periudha ndryshimesh të mëdha në jetën e tyre. Gjatë fazës së adoleshencës, shpesh vërehet një dobësim i lidhjes së tyre me familjen dhe shkollën, çka i bën ata më të prirur për të kërkuar ndjenja përkatësie dhe afërsie në grupe bashkëmoshatarësh, përfshirë grupe me sjellje devijante. Në këto grupe, fëmijët kanë më shumë gjasa të përfshihen në veprime të papërshtatshme, shpesh edhe nën ndikimin e alkoolit apo substancave narkotike. Këto grupe joformale mund të shërbejnë si urë lidhëse me të rritur që synojnë përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale.

Ka disa faktorë që e rrisin ndjeshëm probabilitetin që fëmijët të bien në kontakt me sistemin e drejtësisë, në krahasim me të rriturit. Ndër to: mungesa e pjekurisë, prirja për të marrë rreze, ndikimi i fortë i moshatarëve, kufizimet në zhvillimin konjitiv, problemet e shëndetit mendor dhe përvojat e viktimizimit.

Në vitet e fundit, është vënë re një rritje e numrit të të miturve në konflikt me ligjin, veçanërisht e fëmijëve përsëritës. Kjo situatë kërkon qasje të koordinuar dhe ndërhyrje të specializuara. Legjislacioni shqiptar ka shënuar përparime të rëndësishme në këtë fushë, me miratimin e një kuadri të përditësuar ligjor dhe nënligjor, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve si: Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur,

Ecuria e rasteve tregon se dinamikat janë të ndryshme dhe kompleksiteti i tyre rritet. Kjo sjell një nevojë të vazhdueshme për rritje të kapaciteteve të profesionistëve të linjës së parë dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Në zbatim të **Objektivit Specifik III.4 të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 “Drejtësi miqësore për fëmijët”**, është parashikuar masa për hartimin dhe miratimin e një

marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet ASHDMF-së dhe Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 dhe Planin e Punës të ASHDMF-së dhe QPKMR-së, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe trajnimesh të përbashkëta. ASHDMF, në bashkëpunim me QPKMR, ka organizuar **sesione informuese dhe trajnime në 11 bashkitë**: Malësi e Madhe, Dibër, Shkodër, Gjirokastrë, Kamëz, Dimal, Kuçovë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj dhe Tepelenë. Trajnimet kanë përfshirë **151 profesionistë të vijës së parë si**: punonjës të NJMF-ve, oficerë sigurie në shkollë, punonjës të Shërbimit të Provës, përfaqësues të prokurorisë, strukturave të policisë, seksionit të krimeve, punonjës socialë dhe psikologë.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërtimi i kapaciteteve për identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen në rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes zbatimit të mekanizmave të referimit dhe menaxhimit të rasteve. Në fokus kanë qenë edhe procedurat për menaxhimin e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale.

Përveç trajnimeve me profesionistë, janë organizuar dhe takime informuese e ndërgjegjësuese me **145 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme** në këto bashki. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë fuqizimi i fëmijëve me njohuri ligjore dhe rritja e ndërgjegjësimit të tyre për të qëndruar larg sjelljeve kriminale. Fëmijët janë informuar mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë penale për të mitur, rolin e QPKMR-së, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e tyre. Edukimi ligjor në shkollë është theksuar si një element kyç për parandalimin e devijimeve në sjellje dhe për ruajtjen e sigurisë sociale të fëmijëve.

8. Organizimi i mbledhjes së Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës u mbledh më 10 shtator 2024 me të gjithë aktorët e nivelit qendror e vendor, ku pjesë ishin edhe vetë fëmijët në statusin e observatorit. ASHDMF bashkërendoi punën nën drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për realizimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe miratimi i planit të masave në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Në këtë takim u diskutuan arritjet dhe sfidat në programet dedikuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Së bashku me ministrinë e linjes u dakordësua për vazhdimin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Drejtave të Fëmijëve dhe Konventës së OKB-së. Gjithashtu, u prezantua dhe modeli "Garancia për Fëmijë", si një nga masat prioritare të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030.

9. Aktivitet sensibilizuese që kanë në fokus të drejtat dhe pjesëmarrjen e fëmijëve

6 Shkurt - Dita Botërore e Internetit të Sigurt

Në kuadër të ditës botërore të Internetit të Sigurt MSSHMS dhe ASHDMF në bashkëpunim me Autoritetin për sigurinë Kiberentike zhvilluan në qendrën TUMO aktivitet informues dhe ndërgjegjësues për sigurinë e fëmijëve në internet. Në këtë aktivitet u bë lancimi i planit të përbashkët të veprimit mes AKCESK dhe ASHDMF mbi bashkëpunimin për fushata ndërgjegjësuese dhe Nënshkrimi i Marrëveshjes Ndërinstitucionale mes ASHDMF dhe AKCESK për mbrojtjen e fëmijëve në ambientin digjital.

12 Prill – Dita Kombëtare e Fëmijëve në situatë Rruge

Në kuadër të ditës për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge ASHDMF zhvilloi një takim në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale Tiranë, Qendrën Komunitare të Terrenit, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Komisariateve të Policisë Vendore Tiranë. Në kuadër të plan veprimit të përbashkët për zbutjen e këtij fenomeni që po shndërrohet plagë e thellë për vetë fëmijët dhe shoqërinë u diskutua për forcimin e rolit të profesionistëve si nga ana sociale por edhe ligjore për të frenuar totalisht këtë fenomen. Gjithashtu media duhet të ruaj rolin e saj ndërgjegjësues duke apeluar ndaj shoqërisë, që të raportojnë pranë shërbimeve sociale kur hasin këtë fenomen.

1 Qershor - Dita ndërkombëtare e fëmijëve

ASHDMF së bashku me organizatën World Vision Albania zhvilluan një takim shumë të veçantë së bashku me disa fëmijë të moshave të ndryshme. Takimi u zhvillua në një nga bibliotekat e Bashkisë Tiranë me synimin prezantimin dhe rëndësinë e librit të fëmijët. Qëllimi i këtij takimi ishte se të gjithë fëmijët duhen orientuar drejt rrugës së dijes, biblioteka, lojrave dhe argëtimit në natyrë. Të gjithë fëmijët pjesëmarrës në fund të takimit moren dhuratë nga një libër.

12 Qershor – Dita Kundër Shfrytëzimit për Punë të Fëmijëve

Në kuadër të ditës Kundër Shfrytëzimit për Punë të Fëmijëve ASHDMF së bashku me Qendrën “Gonxhe Bojaxhi” dhe me PMF Tiranë zhvilluan një takim informues dhe ndërgjegjësues me fëmijët që frekuntojnë qendrën, ku diskutuan mbi punën e fëmijëve, rreziqet, parandalimin e punës së fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve nga puna e paligjshme, shfrytëzimi dhe aksesin për të gjithë fëmijët në shkollë.

Fëmijët shprehën shumë interes në marrjen e informacionit dhe ishin shumë interaktiv gjatë diskutimeve. Ata nëpërmjet punimeve dhe vizatimeve përcollën shumë mesazhe sensibilizuese kundër punë fëmijëve, aksesit në arsim.

18 Nëntor - Dita ndërkombëtare kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve

Në datën 18 nëntor 2024, ditën ndërkombëtare kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve u zhvillua workshop për sigurinë e fëmijëve në mjedisin digjital, duke patur në fokus mbrojtjen nga shrytëzimi dhe abuzimi online për fëmijët. Morën pjesë përfaqësues nga Policia e Shtetit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKEP, Ministria Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, oficerë të sigurisë në shkollë, punonjës për mbrojtjen e fëmijës, nxënës dhe prindër.

20 Nëntor - Dita ndërkombëtare e fëmijëve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Fëmijët, më 20 nëntor 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe gjithashtu me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, organizuan një takim me 30 fëmijë nga 5 bashki: Shkodër, Elbasan, Tiranë, Kamëz, Burrel. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve u diskutua së bashku me fëmijët. Pas këtij takimi të parë, fëmijët do të organizojnë 4 workshope me grupe më të mëdha fëmijësh në rrethet e tyre. Në fund të workshope-ve, fëmijët do të paraqesin një raport përmbledhës të të gjitha rekomandimeve të bashkëmoshatarëve të tyre.

REKOMANDIME

1. Zhvillimi i shërbimeve të specializuara dhe gjithëpërfshirëse

- Të ngrihen dhe forcohen **shërbime rehabilituese të specializuara për kategori të veçanta** të fëmijëve, si: fëmijët viktimë të abuzimit seksual, fëmijët përdorues të substancave narkotike, fëmijët me probleme të shëndetit mendor dhe fëmijët në konflikt me ligjin.
- Të krijohen **shërbime pritëse dhe afatmesme** për fëmijët e huaj të pashoqëruar, duke tejkaluar modelin e vetëm të strehimit emergjent dhe duke përfshirë mbështetje psikologjike, juridike dhe sociale.

2. Mbështetje për familjen dhe parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit

- Të zhvillohen **programe për riaftësim dhe fuqizim prindëror**, për të përmirësuar aftësitë e prindërimit, të mundësohet kthimi i fëmijës në familje në rastet e përkujdesjes alternative dhe të parandalohet institucionalizimi i panevojshëm.
- Të ofrohen **shërbime për ndërmjetësim dhe rregullim të marrëdhënieve familjare**, në mënyrë që fëmijët të mund të qëndrojnë në mjedise të sigurta dhe mbështetëse.

3. Rritja e ndërgjegjësimit dhe detyrimit për referim të rasteve të dhunës

- Të forcohet zbatimi i **detyrimit ligjor për referimin e rasteve të dhunës apo abuzimit**, duke përfshirë mësuesit, psikologët e shkollës, mjekët, infermierët, punonjësit e institucioneve të kujdesit për fëmijët dhe punonjësit e policisë.
- Të realizohen **fushata informuese për profesionistët** mbi mekanizmat ekzistues të raportimit dhe adresimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

4. Fuqizimi i shërbimit psiko-social në shkolla

- Të përmirësohet dhe zgjerohet **prania dhe cilësia e shërbimit psiko-social në shkollat publike**, përmes rritjes së numrit të psikologëve dhe përgatitjes profesionale të tyre.
- Të forcohet **ndërlidhja ndërmjet sistemit arsimor dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijës**, për identifikimin dhe menaxhimin e hershëm të rasteve me risk.

5. Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme profesionale

- Të hartohet një **plan për trajnimin e vazhdueshëm të PMF-ve dhe aktorëve vendor**, për të garantuar rritje profesionale dhe për të përballuar lëvizshmërinë e lartë të stafit në nivel vendor.
- Të sigurohet mbështetje teknike dhe supervizim për raste të ndërlikuara dhe për vendimmarrje të ndjeshme.

6. Rritja e ndërgjegjësimit publik për sigurinë online të fëmijëve

- Të organizohen aktivitete të qëndrueshme ndërgjegjësuese me prindër dhe aktorë publikë, për sigurinë e fëmijëve në internet dhe mbrojtjen nga rreziqet dixhitale.
- Të integrohen temat e sigurisë dixhitale dhe etikës online në kurrikulat e shkollave në bashkëpunim me MAS.

7. Angazhimi i bashkive për politika dhe buxhet të dedikuar për fëmijët

- Të kërkohet që çdo bashki të hartojë dhe zbatojë plane lokale të të drejtave të fëmijëve me buxhet të dedikuar, duke përfshirë masat për strehim, punësim dhe mbështetje për familjet në pamundësi ekonomike.
- Të krijohen mekanizma të monitorimit të buxhetimit social për fëmijët, si pjesë e planifikimit dhe raportimit të buxhetit vjetor të bashkive.

8. Forcimi institucional i ASHDMF

- Të rritet **buxheti vjetor dhe numri i stafit teknik të ASHDMF**, për të mundësuar një koordinim më efikas ndërinstitutional dhe një mbulim më të gjerë monitorimi dhe mbështetjeje në nivel vendor.
- Të sigurohet **ristrukturimi organizativ i Agjencisë** për t'i përshtatur burimet e saj ndaj prioritetëve të reja si mbrojtja në mjedisin dixhital dhe ndihma për fëmijët në situata të jashtëzakonshme.